



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

EMERGJENCA CIVILE

Nr. 1628 Prot.

Krumë me, 15/05 2024.

PLAN – VEPRIMI

**MBI BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE PËR
PARANDALIMIN, MBROJTJEN DHE PËRGJIGJEN
NDAJ SITUATAVE TË MUNDSHME PËR ZJARRET**

2024

*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

Në mbështetje të akteve ligjore:

- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”.
- Ligji nr. 45, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
- Ligji nr. 152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”
- Ligji nr.57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”

- VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile”.
- Planit të Mbrojtjes Civile të Rrethit Has.

OBJEKTIVI: PËRGJIGJEN E PËRBASHKËT TË STRUKTURAVE SHTETËRORE, PËR SITUATËN E PRITËSHME TË ZJARRËVE.

Duke marrë parasysh që pyjet zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në Bashkinë Has, një nga objektivat kryesore do të jetë mbrojtja e tyre nga zjarret. Periudha e fillimit të rënies së zjarreve në pyje dhe kullota përkon me periudhën Qershor - Tetor. Megjithatë shkaqet e panjohura zënë vendin kryesor, pjesa më e madhe e zjarreve janë shkaktuar nga pakujdesia njerëzore, por nuk mungojnë edhe rastet e qëllimshme të vëna në disa Njësi Administrative. Rrethi ynë renditet ndër qarqet me situatë të rënduar të zjarreve në pyje e kullota, si rezultat i favorizimit nga kushtet atmosferike dhe temperaturat e larta, në këto kushte:

URDHËROJ:

1. Përditësimin e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Has me detyra përkatëse për të gjithë anëtarët.

Komisioni i Mbrojtjes Civile do të drejtohet nga Kryetari i Bashkisë me detyra ekskluzive specifike për të gjithë anëtarët.

2. Detyrat e Komisionit të Mbrojtjes Civile :

1. Bazuar në të dhënat dhe eksperiencat e mëparshme të institucioneve pjesmarrëse të identifikohen zonat me rrezik të shtuar të cilat do të raportohen me shkresë zyrtare Prefektit të Qarkut, Komisionit të M.C-së Qarkut, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Drejtorinë Operacionale e Drejtim Komandimit.

2. Harton Planet e Mbrojtjes Civile dhe Plan Veprimet sipas niveleve.

3. Marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave shtetërore bashkiake e private nga zjarret duke këshilluar për planizimin e masave parandaluese si dhe duke u angazhuar në rast të operacioneve të fikjes së zjarreve.

4. Evidentojnë operatorët e ndryshëm që ushtrojnë e kanë të vendosur aktivitetin e tyre në pyje kullota e toka bujqësore.

5. Ushtrijnë kontrolle në terren mbi zbatimin e dispozitave ligjore e të akteve nënligjore në fuqi për mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarret dhe të informojnë, për problemet e shqetësimet që kanë në fushën e mbrojtjes e menaxhimit.

6. Shkëmbejnë informacione dhe kordinojnë veprimet, për zbulimin e shkaktarëve dhe gjetjen e autorëve të zjarreve si dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore.

7. Bllokojnë ushtrimin e veprimtarisë brenda fondit pyjor e kullotave dhe atij bujqësor të çdo personi fizik e juridik që nuk respekton masat teknike, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

8. Gjatë fazës së përgjigjes në rast zjarresh të sigurohet mbështetje e përshkallëzuar në operacione me forcat dhe logjistikën e nevojshme si dhe të informohet në linjën e vartësisë përkatëse.

9. Merr masa për vlerësimin e nevojave gjatë gjithë ciklit të emergjencës.

3. Detyrat e Kryetarit të Bashkisë:

1. Drejton Komisionin e Mbrojtjes Civile të Bashkisë dhe aktivitetin e marrjes së masave paraprake, parandalimin e zjarrëve dhe përgjigjes në rast nevoje.

2. Organizon dhe bashkërendon punën për hartimin e planeve të përgatitjes dhe zbatimin e masave mbrojtëse ndaj zjarrëve.

3. Cakton drejtuesin e operacionit për përballimin e rasteve të zjarrit.

4. Paraqet kërkesën zyrtare për ndihmë në rast nevoje në burime njerëzore e logjistike si dhe kordinon operacionet e marrjes së ndihmës në qark.

5. Mbikqyr, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë në terren, mbi punën me kryetarët e Njesive Administrative dhe Kryetarët e fshatrave, si dhe informon në mënyrë periodike te Prefekti i Qarkut dhe në AKMC-në për nevojat e ndryshme.

6. Në bazë të buletinit të parashikimit të motit njofton Njësitë Administrative dhe siguron, përshtat dhe shpërndan sipas nevojave mjetet e llogjistikën për operacionet e mundshme të shpëtimit.

7. Siguron nepërmjet MZSH-së, efektivat dhe llogjistikën e nevojshme për shpëtimin e jetës së qytetarëve në zonat me rrezik të shtuar.

4. Detyrat e Këshillit Bashkiak:

Kryetari i Këshillit të Bashkisë është zv/ drejtues i KMC-së Bashkisë.

Të ndikojë së bashku me Kryesinë e Këshillit të Bashkisë në përdorimin sa më efikas të burimeve financiare dhe të përdorimit të fondit rezervë.

Mban lidhje të vazhdueshme me Njësitë Administrative.

5. Detyrat e Shërbimit Pyjor të Bashkisë, Administrata e Zonave të Mbrojtjes e Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit dhe Mbrojtjes Territorit.

1. Hartojnë Planin e Veprimit për menaxhimin e zjarrit në pyje e kullota e objektet e veçanta.
2. Krijojnë grupin e punës për menaxhimin e situatave të mundshme të emergjencës nga zjarri i cili bën vlerësimin konkret të situatave të krijuara, marrin vendime dhe masa suplementare që kanë si objekt parandalimin dhe fikjen e zjarreve.
3. Hartojnë dhe shpërndajnë komunikata periodike për shtyp me qëllim informimin dhe sensibilizimin e opinionit publik për situatën e zjarreve.
4. Ushtrijnë kontrole nga strukturat e vartësisë për zbatimin e masave për mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarri.
5. Mbajnë kontakte me institucionet e agjencitë e tjera shtetërore e private për kordinimin e punës për parandalimin dhe reagimin në raste të zjarreve.
6. Në bashkëpunim me AZM-në përcaktojnë veprimet e përbashkëta në objektet të cilat monitorohen nga ky institucion.
7. Emërojnë person kontakti për çdo Njesi Administrative me qëllim kordinimin e veprimeve me KMC-në e Bashkisë për hartimin e informacioneve bazë të ndërhyrjes dhe dorëzon listën pranë KMC -së Bashkisë.
8. Sipas nevojave të situatës dhe të konfirmuar nga personi i kontaktit mundësojnë mbështetjen me logjistikë shtesë, për zonat më të prekura.
9. Të organizojnë strukturat e shërbimit pyjor dhe në bashkëpunim me autoritet vendore të sigurojë trajnimin e grupeve vullnetare dhe të banorëve të fshatit.
10. Të kenë në gadishmëri sistemin e radiokomunikimit për zonën që mbulon.

6. Komisariati Vendor i Policisë.


1. Të mundësojë mbështetje për ndërhyrjen në zonat e rrezikuara me mjete shpëtimi dhe mjete me kalueshmëri të lartë dhe ti vejë në dispozicion të KMC-së Bashkisë.
2. Të dislokojë njësitë e forcave për evakuimin e personave të rrezikuar nga zjarri.
3. Të bashkëpunojë me Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit dhe Mbrojtjes Teritorit si dhe strukturat e tjera shtetërore për goditjen e paralizimin e veprimtarisë keqbërëse për zjarret në pyje.

7. Detyrat e Njesive Administrative:

1. Përfaqësues të Njesive Administrative marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetin e grupeve të KMC-së Bashkisë dhe raportojnë në mënyrë periodike pranë Kryetarit të Bashkisë.
2. Të freskojnë planet e gadishmërisë në nivel Njesie Administrative, për përballimin e emergjencave verore dhe ti raportojë ato pranë Kryetarit të Bashkisë.
3. Të evidentojnë nevojat dhe të ofrojë ndihmën për banorët në çdo rast për përmbushjen e nevojave jetike.
4. Të evidentojnë zonat e rrezikuara nga zjarret gjatë stinës së verës.
5. Të organizojnë sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit.
6. Të organizojnë punën për shuarjen e zjarrëve në bashkëpunim me Kryetarët e fshatrave e grupet e vullnetarëve të trajnuar në këtë drejtim.
7. Të marrë masa konkrete për parandalimin e zjarrëve në njësitë që mbulon dhe për shmangien e rreziqëve që kërcënojnë jetën e banorëve.

Të gjitha strukturat raportojnë gjatë gjithë kohës në KMC-në e Bashkisë për situatat dhe marrjen e masave për përballimin e problemeve që rrjedhin nga situatat emergjente.

KRYETARI


Miftar DAUTI